



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 11.03.2019

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM
FINANCIAR 2017, PËR PROJEKTIN “PROGRAMI PËR RINOVIMIN E
KONVIKTEVE NË KAMPUSIN UNIVERSITAR TË TIRANËS, SIPAS PARIMIT
TË EFIÇENCËS ENERGJITIKE, FAZA III”

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 11.03.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2017, “Për programin për rinovimin konvikteve në Kampusin Universitar të Tiranës sipas parimit të efikasitetit energjetike, faza III”, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për të mbrojtur projektligjin në emër të Qeverisë, ishin prezent përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

II. Baza kushtetuese e projektligjit

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Projektligji i propozuar ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2017, për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës, sipas parimit të efikasitetit energjetic, faza III”.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është rehabilitimi i konvikteve të Universitetit të Tiranës, duke synuar kursime të ndjeshme të energjisë, kushte jetese të përshtatshme dhe kosto të arsyeshme akomodimi elementë këto që vlerësohen se do të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik e social të vendit tonë përmes:

- Krijimit të kushteve më të mira të jetesës dhe studimit për një numër të konsiderueshëm studentësh;
- Uljes së ndjeshme të kostove që duhet të paguajë Bashkia Tiranë dhe Rezidenca Studentore Universitare nr.1;
- Krijimit të një modeli ekonomik të caktuar, i cili mund të aplikohet në shumë projekte të tjera publike.

Me anë të kësaj marrëveshjeje palët bien dakord për akordimin e një granti nga Qeveria Gjermane, me vlerën deri në 2 927 765,96 euro për fazën e III-të, financim i cili do të vihet në dispozicion nëpërmjet KFW-së, me nënshkrimin e marrëveshjes financiare.

IV. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Relatori i Komisionit, shpjegoi se, marrëveshja është miratuar në parim me VKM nr. 734, datë 12.12.2018, është nënshkruar nga palët dhe bazuar në nenin 17 të ligjit të 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare” i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë për ratifikim.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje, propozohet në vijim të marrëveshjeve financiare të nënshkruara me KFW-në respektivisht në vlerën prej 4 500 000 eurosh për fazën e I-rë dhe në vlerën prej 2 032 179.23 eurosh për fazën e II-të. Marrëveshja mundëson dhënien

e një granti nga Qeveria Gjermane, me vlerën deri në 2 927 765,96 euro për fazën e III-të, financim i cili do të vihet në dispozicion nëpërmjet KFW-së, me nënshkrimin e marrëveshjes financiare.

Programi synon rehabilitimin e konvikteve të Universitetit të Tiranës, në funksion të rritjes së efikasitetit të energjisë dhe të kushteve të përshtatshme të studentëve, sipas kërkesave minimale të performancës së energjisë. Në varësi të buxhetit në dispozicion, projekti do të përfshijë rehabilitimin e konvikteve nr. 3, 14, 16, 17 dhe 18 dhe nëse do të jetë e mundur edhe të dy deri në 4 godina të tjera konviktesh.

Përveç rehabilitimit energjetik të ndërtesave, programi do të mbulojë në mënyrë të konsiderueshme masat themelore të konfortit, sipas kushteve të vendosura nga ligji nr.116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave”, të tilla si: rinovimi i instalimeve sanitare, rinovimi i pajisjeve elektrike, sistemi i ngrohjes, ftohjes, ventilimit, prodhimit të ujit të ngrohtë sanitar, masat e sigurisë, etj., në mënyrë që të përmirësohet jetesja dhe mjedisi i të mësuarit për studentët.

Objektivat e këtij projekti lidhen me komponentët e më poshtëm:

- Auditimi energjetik i ndërtesave për të identifikuar konsumin e energjisë dhe masat përkatëse që duhen për të reduktuar konsumin e energjisë.
- Identifikimi i nevojave të rinovimit të ndërtesave në lidhje me gjendjen aktuale të tyre për të zgjidhur ciklin e jetës së ndërtesave;
- Identifikimi i masave të ndryshme të efikasitetit të energjisë që mund të aplikohet, si dhe llogaritja e kursimit të energjisë në secilën prej godinave, me qëllim përcaktimin e kriterëve dhe të masave të efikasitetit të energjisë me një kosto të lartë përfitimi;
- Reduktimi i konsumit të përgjithshëm të energjisë së ndërtesave, dhe siguri i përmirësimit të kushteve të jetesës së studentëve.
- Llogaritjen e reduktimit të karbonit si rezultat i masave dhe vendosjes në kushte të performancës së lartë dhe të standardeve të Bashkimit Evropian.

Ky projekt është në përputhje me Strategjinë për zhvillimin e sektorit energjetik ku pjesë e analizës janë dhe ndryshimet shumë të domosdoshme në lidhje me rritjen e sigurisë për furnizimin me energji dhe optimizimin e burimeve të energjisë, me qëllim përmbushjen e kërkesës dhe arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm në të ardhmen.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë e të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, dhanë sqarime të detajuara lidhur me benefitet e kësaj marrëveshje duke ritheksuar objektivat e këtij projekti dhe qëllimin parësor të tij që konsiston në rehabilitimin e konvikteve të Universitetit të Tiranës, duke synuar kursime të ndjeshme të energjisë dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së studentëve që do të akomodohen.

Institucioni përgjegjës për zbatimin e projektit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila do të bashkëpunojë ngushtë me Bashkinë e Tiranës, si institucioni që ka

në përgjegjësi administrimi konviktet, si dhe me administratën e Rezidencës Studentore Universitare nr.1, Tiranë.

Anëtarët e komisionit, gjithashtu gjatë shqyrtimit të kësaj marrëveshjeje diskutuan edhe lidhur me ecurinë e nënshkrimit të kontratës së financimit si dhe mbi ecurinë e deritanishme të zbatimit të marrëveshjeve financiare të lidhura me Qeverinë Gjermane për programin e rehabilitimit të konvikteve faza e I-rë dhe e II-të dhe vlerësimin e impaktit të tyre ekonomik dhe social.

V. Përfundime

Në përfundim, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, duke evidentuar faktin se kjo marrëveshje është në përputhje me Kushtetutën si dhe legjislacionin në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare si dhe duke vlerësuar se marrëveshja do të mundësojë arritjen e qëllimit, rehabilitimin e konvikteve të Universitetit të Tiranës, duke synuar kursime të ndjeshme të energjisë, kushte jetese të përshtatshme dhe kosto të arsyeshme akomodimi, me votat e gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi.

RELATOR

Arben AHMETAJ

KRYETAR

Arben AHMETAJ